



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Shk.II.nr.1440/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtarja Franciska Zhitija Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Eurosped D.D.O., me seli në Beograd, Serbi, me autorizim e përfaqëson Visar Ostrozubi, avokat nga Prizreni, kundër debitorit TLW L.L.C., me seli në Prishtinë, rr. Ndërmarrja e Re Fabrika e Amortizorëve, nr. 21, me drejtor V.U., i përfaqësuar nga Fisnik Sogojeva avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1882/22 të datës 31.08.2023, me datë 22.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.REFUZOHEN si të pa bazuara ankesat e kreditorit Eurosped D.D.O., me seli në Beograd, Serbi, dhe ankesa e debitorit TLË L.L.C., me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1882/22 të datës 31.08.2023, **VËRTETOHET**.

II. Hudhet si e palejuar ankesa e debitorit TLW L.L.C., me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1882/22 të datës 31.08.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit TLW L.L.C., me seli në Prishtinë, ashtu që e ka anuluar pjesërisht urdhrin përmbarimor P.nr.69/22, të datës 28.02.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Rushit Hoxha, sa i përket borxhit në shumën prej 8,950.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% për faturat: Nr. 02/104 të datës 21.12.2020, Nr. 02/110 të datës 31.12.2020, Nr.02/11 të datës 31.12.2020, Nr.02/5 të datës 30.01.2021 dhe Nr.02/8 të datës 09.02.2021, në pikën II, ka mbetë në fuqi pjesa tjetër e urdhëri përmbarimor P.nr.69/22, të datës 28.02.2022, të lejuar nga Përmbaruesi

Privat Rushit Hoxha, sa i përket shumës prej 6,300.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, për faturat : Nr.02/2 të datës 30.01.2021, Nr.02/3 të datës 30.01.2021 dhe Nr.02/4 të datës 30.01.2021, në pikën III, ka përfunduar pjesërisht procedura përmbarimore të kreditorit Eurosped D.D.O., me seli në Beograd, Serbi, sipas urdhërit përmbarimor P.nr.69/22 të datës 28.02.2022, në shumën prej 8,950.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% për faturat: Nr. 02/104 të datës 21.12.2020, Nr. 02/110 të datës 31.12.2020, Nr.02/11 të datës 31.12.2020, Nr.02/5 të datës 30.01.2021 dhe Nr.02/8 të datës 09.02.2021.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori Eurosped D.D.O., me seli në Beograd, Serbim pa i përmendur shkaqet ankimore, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1882/22 të datës 31.08.2023, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e kreditorit dhe të ndryshohet aktvendimi i atakuar ose të njëjtin ta rikthej në rishqyrtim ose rivendosje.

Po ashtu edhe debitorit ka paraqitur ankesë, pa i përmendur shkaqet ankimore, me të cilën e ka kontestuar në tërësi aktvendimin e Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë KPPP.nr.1882/22 të datës 31.08.2023, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e debitorit, të ndryshohet aktvendimi i atakuar dhe të anulohet urdhëri përmbarimor dhe të detyrohet kreditori të paguaj shpenzime procedurale.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesat e kreditorit është e pa bazuara.

Ankesa e debitorit është e palejuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, me datën 28.02.2022 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbarimit, kundër debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturave për shumën e borxhit prej 15,250.00 €.

Përmbaruesi Privat Rushit Hoxha, me seli në Prizren, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka caktuar urdhrin P.nr.69/22, të datës 28.02.2022, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Nr. 02/104 të datës 21.12.2020, Nr. 02/110 të datës 31.12.2020,

Nr.02/11 të datës 31.12.2020, Nr.02/5 të datës 30.01.2021, Nr.02/8 të datës 09.02.2021, Nr.02/2 të datës 30.01.2021, Nr.02/3 të datës 30.01.2021 dhe Nr.02/4 të datës 30.01.2021, duke urdhëruar debitorin t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 15,250.00 €, me kamatë ligjore prej 8% prej ditës kur është bërë kërkesa e arritshme si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore duke përfshirë edhe shpenzimet e avokatit sipas rregullores për Tarifën e Avokatëve, nën kërcënimin të përmbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, përmbushja e detyrimit të realizohet përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe transferimin e tyre në llogarinë e kreditorit, sekuestrimin e letrave me vlerë, sekuestrimi, vlerësimi shënimi i përmbarimit në librin publik të paluajtshmërive, shitjen e sendeve dhe përmbushjen e detyrimit të kreditorit, të bëhet përmbarimi në pjesën e pasurisë së debitorit në shoqërinë tregtare, dorëzimi i sendeve të luajtshme dhe kreditori të fitoj të drejtën e pengun në sendet e luajtshme.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1882/22 të datës 31.08.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar prapësimin e debitorit TLË L.L.C., me seli në Prishtinë, ashtu që e ka anuluar pjesërisht urdhrin përmbarimor P.nr.69/22, të datës 28.02.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Rushit Hoxha, sa i përket borxhit në shumën prej 8,950.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% për faturat: Nr. 02/104 të datës 21.12.2020, Nr. 02/110 të datës 31.12.2020, Nr.02/11 të datës 31.12.2020, Nr.02/5 të datës 30.01.2021 dhe Nr.02/8 të datës 09.02.2021, në pikën II, ka mbetë në fuqi pjesa tjetër e urdhëri përmbarimor P.nr.69/22, të datës 28.02.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Rushit Hoxha, sa i përket shumës prej 6,300.00 euro, me kamatë ligjore prej 8%, për faturat : Nr.02/2 të datës 30.01.2021, Nr.02/3 të datës 30.01.2021 dhe Nr.02/4 të datës 30.01.2021, në pikën III, ka përfunduar pjesërisht procedura përmbarimore të kreditorit Eurosped D.D.O., me seli në Beograd, Serbi, sipas urdhërit përmbarimor P.nr.69/22 të datës 28.02.2022, në shumën prej 8,950.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% për faturat: Nr. 02/104 të datës 21.12.2020, Nr. 02/110 të datës 31.12.2020, Nr.02/11 të datës 31.12.2020, Nr.02/5 të datës 30.01.2021 dhe Nr.02/8 të datës 09.02.2021.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret – në pikën I, sipas Faturave Nr. 02/104 të datës 21.12.2020, Nr. 02/110 të datës 31.12.2020, Nr.02/11 të datës 31.12.2020, Nr.02/5 të datës 30.01.2021 dhe Nr.02/8 të datës 09.02.2021, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe 37 të LPP-së. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë dokumenti – Faturave , në bazë të së

cilës është lejuar propozimi për përmbardim, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se këto fatura në rastin konkret nuk përmbajnë nënshkrimin apo vulën e debitori, rrjedhimisht të njëjtat rezultojnë të mos jenë pranuar asnjëher nga debitori. Në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi urdhrin e përmbarduesit privat P.nr.69/22 të datës 28.02.2022, për pjesën tjetër të detyrimit në shume prej 6,300.00 € për faktin se dokumenti i besueshëm - Fatura : Nr.02/2 të datës 30.01.2021, Nr.02/3 të datës 30.01.2021 dhe Nr.02/4 të datës 30.01.2021, pasi që urdhri i lejuar nga ana e Përmbarduesit Privat bazohet në dokumentin e besueshëm përkatësisht faturave të lartcekura të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë të përmbardueshëm ngase, janë pranuar nga debitori, gjithashtu këto fatura plotësojnë kushtet nga nenet 29 të LPP-së, ku përcaktohet se : *“Përmbardimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa para 3 përcakton se : *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbardim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbardjes së detyrimit monetar”*. Ndërsa sipas nenit 37 të LPP-së përcakto se : *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*. Sa i përket kamatës prej 8% gjykata u bazua në nenin 382 të LMD-së me të cilin përcaktohet se : *“Debitori që vonon në përmbardjen e detyrimit në të holla, debiton përpos borxhit kryesor edhe kamatën”*.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbardimore me rastin e vendosjes për aprovim të pjesshëm të prapësimin të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar si në pikën I të dispozitivit, ku Faturat e lartë cekura nuk janë pranuar nga debitorit dhe mungon nënshkrimi i tij. Në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar kushtet ligjore nga Neni 29 par. 3 i LPP-së, i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për*

përmbajmë po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar". Gjithashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë dhe saktë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se në pikën, II të dispozitivit duke lënë në fuqi urdhërin përmbajmë, për dokumenti i besueshëm në faturat e lartëcekura, në shumën e përgjithshme prej 6,300.00 €, pasi që këto fatura të lartëcekura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së ku përcakton se *"Dokumentit i besueshëm është i përshatshëm për përmbajmë po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar"*, pra janë treguar palët, mallrat/ shërbimet që janë objekt i këtyre faturave. Gjithashtu këto fatura burojnë nga kontrata e rregullt që është vërtetuar edhe me mos kontestimit të debitorit ndaj këtyre detyrimeve që janë prezentë në këto fatura.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se dhomat e shkallës së parë kanë konstatuar drejtë se faturat të cilat janë cekur në dispozitivin e I të aktvendimit të ankimuar, si dokumente të besueshëme mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbajmore, respektivisht është lejuar përmbajmë nuk i plotësojnë kushtet në mënyrë kumulative që duhet t'i ketë dokumentet e besueshëme. Në rastin konkret qartë rezulton se disa faturat nuk janë pranuar nga debitori dhe janë të një anëshme, për të cilin është ndër kushtet esenciale mbi bazën e së cilës dokumenti i besueshëm fiton tipare të përmbajmërisë së titullit ekzekutiv, mbi bazën e së cilës mund të konstatohet ekzistimi i detyrimit dhe pranimit si i tillë nga debitori. Sa i përket faturave tjera që janë të lartëcekura si në pikën II të dispozitivit të aktvendimit të ankimuar, ato përmbajnë të gjitha tiparet nga dispozitat e LPP-së, pasi që të njëjtat janë të pranuar dhe konfirmuar nga debitori me email dt.01.02.2021, si dhe të njëjtat nuk janë kundërshtuar nga debitori.

Gjykata Komerciale - Dhomat e shkallës së dytë duke shqyrtuar pretendimet ankimore të kreditorit, por vlerësojë se janë tërësisht të paqëndrueshme pretendimet e kreditorit se të gjithë faturat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm ashtu siç është paraparë me nenin 29 par. 1.3 të LPP-së.

Po ashtu kjo gjykatë e hudhi si të pa lejuar ankesën e debitori pasi që i njëjti nuk ka vepruar sipas aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë KPPP.nr.1882/22 dt.20.09.2023, ku debitori është urdhëruar që në rast të paraqitjes së ankesës të paguaj garancionin sipas nenit 78 par.1 të LPP-së, andaj në bazë të paragrafit 4 të nenit 78 të të njëjtit ligj debitori nuk ka paguar garancion

për paraqitjen e ankesës, kështu pagesa e garancionit nga debitori nuk gjindet në shkresa të lëndës e as ndonjë kërkesë për lirim të saj të drejtuar gjykatës së shkallës së parë, andaj kjo gjykatë e hudhi si të palejuar ankesën e debitorit.

Andaj edhe gjykata e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përbarimore organi përbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përbarues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me vërtetimin të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përbarimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e shkallës së dytë

K.Dh.Shk.II.nr.1440/23 dt. 22.09.2024

Gjyqtarja
Franciska Zhitija Ymeri